



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-124

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-203 PËR
METROLOGJI**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-203
PËR METROLOGJI**

Neni 1

1. Neni 1 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj rregullon sistemin e njësive matëse, etalonët shtetërorë, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e para-paketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbikëqyrjen metrologjike si dhe përgjegjësitë e Drejtoratit të Metrologjisë të Kosovës

Neni 2

1. Neni 3 i ligjit bazik nënparagrafët 1.30. dhe 1.31. fshihen nga teksti i ligjit.

2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1.27. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.27. Autorizimi është dhënia e të drejtës subjekteve juridike për të kryer shërbime të metrologjisë ligjore të mjeteve matëse në sferën e detyrueshme.

3. Neni 3 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.34. shtohen tre nënparagrafë të ri 1.35,1.36,1.37, me tekstin si në vijim:

1.35. **Metrologji shkencore** - pjesa e metrologjisë, e cila merret me realizimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e etalonëve shtetëror të matjeve

1.3.6 **Metrologji industriale** - pjesa e metrologjisë, me të cilën realizohet krahasimi i rezultateve të matjes.

1.37 **Metrologji ligjore** - pjesa e metrologjisë, e cila rregullohet me ligj dhe dispozita të tjera, për sigurimin e saktësisë dhe të besueshmërisë në rezultatet e matjes në fushat ku aplikohen instrumente matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 3

1. Neni 4 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 4

Organizimi i Drejtoratit të Metrologjisë të Kosovës

1. Drejtorati i Metrologjisë të Kosovës është institucion në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe është përgjegjës për vendosjen, zhvillimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të metrologjisë, përfshi edhe fushën e metaleve të çmuara

2. Drejtorati i Metrologjisë të Kosovës drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm Emërimi, shkarkimi, funksionet dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm realizohen në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Rregulloren për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese.

3. Rekrutimi i zyrtarëve të Drejtoratit të Metrologjisë të Kosovës bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara dispozitat ligjore në fuqi për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Organizimi dhe funksionimi i Drejtoratit të Metrologjisë të Kosovës rregullohet me akt nënligjor për organizimin dhe strukturimin e brendshëm të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

2. Pas nenit 4 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 4.A me tekstin si në vijim:

Neni 4.A
Sistemi shtetëror i metrologjisë

1. Sistemi shtetëror i metrologjisë përbëhet nga:

1.1. Drejtorati i Metrologjisë të Kosovës;

1.2. Laboratorët e etalonëve shtetëror;

1.3. Laboratorët e kalibrimit;

1.4. Laboratorët e testimit;

1.5. Organizmat certifikues, që merren me certifikimin e materialeve referuese në fushën e metrologjisë;

1.6. Subjektet e autorizuar nga Drejtorati i Metrologjisë të Kosovës, për të kryer detyra të metrologjisë ligjore sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Neni 4

Titulli i nenit 9 i ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 9
Detyrat e laboratorëve të etalonëve shtetëror

Neni 5

Pas nenit 13 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 13.A me tekstin si në vijim:

Neni 13.A
Miratimi i tipit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara

1. Drejtori i Drejtoratit të përgjithshëm të Metrologjisë, miraton tipin e mjeteve matëse, pas rekomandimit të zyrtarëve përgjegjës të Drejtoratit, kur ky mjet matës i plotëson kërkesat teknike dhe metrologjie të parapara.

2. Drejtori merr vendim për refuzim apo heqjen e mjeteve matëse, pas rekomandimit të zyrtarëve përgjegjës të Drejtoratit kur ky mjet matës nuk i plotëson kërkesat teknike dhe metrologjie të kërkuara, të përcaktuara për një procedurë testimi.

3. Kundër vendimit për refuzimin apo heqjen e mjeteve matëse, mund të bëhet ankesë pranë komisionit profesional për ankesa i cili formohet me vendim të Ministrit të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

4. Komisioni profesional për ankesa përbëhet prej tre (3) anëtarëve, dy (2) anëtarë të përhershëm dhe një (1) anëtarë caktohet nga rasti në rast.

5. Mandati i anëtarëve të komisionit profesional për ankesa është tre (3) vjeçar.

6. Me akt nënligjor përcaktohen procedurat e miratimit të tipit të mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara.

Neni 6

1. Neni 30 i ligjit bazik, paragrafët 1. dhe 2. fshihen dhe riformulohen në një paragraf të vetëm, me tekstin si në vijim:

1. Drejtori i Drejtoratit mund të autorizon subjektet juridike të cilët plotësojnë kushtet për kryerjen e verifikimit, riparimin e mjeteve matëse në qarkullim publik.

2. Neni 30 i ligjit bazik, paragrafi 3., referenca “**sipas paragrafit 2. të këtij neni**” zëvendësohet me referencën “**sipas paragrafit 1. të këtij neni**”.

Neni 7

1. Neni 31 i ligjit bazik, paragrafi 1, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Drejtori i drejtoratit në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës nxjerr vendim për autorizim apo refuzim të kërkesës.

Neni 8

1. Neni 38 i ligjit bazik, në titull fshihet shkurtesa “**LQMK**”.

2. Neni 38 i ligjit bazik, paragrafi 4. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 9

1. Neni 39 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Gjatë mbikëqyrjes inspektori i metrologjisë dhe inspektori i tregut ka për detyrë të verifikoj.

2. Neni 39 i ligjit bazik, paragrafi 2. pas fjalës “**inspektori**” shtohet fjala “**metrologjisë**” dhe nënparagrafi 2.6. fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 10

1. Neni 42 i ligjit bazik, paragrafi 2. togfjalëshi “**inspektori i metrologjisë**” zëvendësohet me togfjalëshin “**inspektori i tregut**”.

Neni 11

Neni 44 i ligjit bazik, paragrafi 3, ndryshohet afati prej “**(10) ditësh**” në “**(30) ditë**”.

Neni 12

Pas nenit 44 të ligjit bazik, shtohet nen i ri 44.A me tekstin si në vijim:

Neni 44.A

Inspektorati i Tregtisë

1. Inspektorati i tregut e mbikëqyrë: përdorimin e njësive matëse ligjore, e mjeteve matëse ligjore dhe vlefshmërinë e verifikimit të mjeteve matëse ligjore, shenjat në produktet e para-paketuara, si dhe kontrollimin e sasive të deklaruara të mbushjes së para-paketimeve.

2. Nëse inspektori i tregut gjatë mbikëqyrjes konstaton shkeljen e dispozitave të këtij ligji, atëherë ndërmer masa të përshkruara me këtë ligj apo dispozita tjera të ligjit për Inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut.

3. Inspektori i tregut është i obliguar të inicion procedurë kundërvajtës në gjykatat kompetente brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, për shkeljet e konstatuara me legjislacionin në fuqi.

Neni 13

1. Neni 45 i ligji bazik, paragrafi 1. togfjalëshi “**inspektor i metrologjisë**” zëvendësohet me togfjalëshin “**Inspektor i tregut**”.
2. Neni 45 i ligjit bazik, nënparagrafi 3.1 fjala ” **instrumente**” zëvendësohet me fjalën “**mjeteve**”.

Neni 14

1. Në tërë tekstin e ligjit bazik fjala “**Departament**” zëvendësohet me fjalën “**Drejtorat**”.
2. Në tërë tekstin e ligjit bazik, shkurtesat “**LQMK**” dhe “**IMLK**” fshihen nga teksti i ligjit.

Neni 15 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/L-124
6 shtator 2012

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI